



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM
Nr 47 Datë 10.04.09

MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TE KONKURISIT TE QENDRES SE QYTETIT

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës «Mbi miratimin e buxhetit të konkursit të qendrës së qytetit», bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, në ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në ligjin nr 10025 dt. 27.11.2008, «Për buxhetin e vitit 2009», në Udhëzimin e MF nr 2 dt. 12.01.2009 « Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009» si dhe në VKB nr 12 dt 13.02.2009 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009 », mbështetur në kompetencat që ka si dhe me propozim të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë buxhetin e konkursit të qendrës së qytetit të detajuar si më poshtë :

- Pagesa e studiove përzgjedhëse 5 studio x 1,310,000 lekë = 6,550,000 lekë
- Vlera e kontratës 9,825,000 lekë
- Cmimet: Cmimi i I-rë 655,000 lekë + çmimi i II-të 393,000 lekë = 1,048,000 lekë
- Shpërblimet për anëtarët e jurisë: 917,000 lekë
- Shpenzime akomodimi 1,660,000 lekë
 1. Akomodimi i anëtarëve të jurisë
 2. Dreka + darka e anëtarëve të jurisë
 3. Shpenzimet e udhëtimit
 4. Shpenzimet për ditën e konkursit

Total i buxhetit shkon në vlerën

20,000,000 lekë

2. Ky fond do të përballohet : 14,500 mijë lekë nga fondi i planifikuar për studime në buxhetin e Bashkisë të vitit 2009, kurse vlera prej 5,500 mijë lekë nga fondi i planifikuar për ndriçimin e stadiumit të qytetit. Totali i planifikuar për ndriçimin e stadiumit të qytetit është 10,000 mijë lekë. Fondi prej 4,500 mijë lekë i mbetur nga ndriçimi i stadiumit të qytetit do të kalojë për asfaltimin e rrugëve kryesore të qytetit. Shpërndarja e fondit të planifikuar për ndriçimin e stadiumit të qytetit paraqitet me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00 06260 05	Art 2310000	-10,000,000 lekë
Shtohet	00 01110 05	Art 2300000	+ 1 875 ,000 lekë
Shtohet	00 01110 05	Art 6020000	+ 3 625 ,000 lekë
Shtohet	00 04530 05	Art 2310000	+ 4,500,000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll Arkiv dhe Shërbimeve Mbështetëse.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase

Raimonda Nase